



## **THIRRJE PËR PJESËMARRJE**

# **KONFERENCA E I-rë NDËRKOMBËTARE**

## **“SFIDAT E KËRKIMIT SHKENCOR NË PSIKOLOGJINË E APLIKUAR DHE EDUKIMI”**

*Organizuar nga*

**Departamenti i Psikologjisë**

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

**03 Qershor, 2022**

**Në bashkëpunim me:**



Departamenti i  
Psikologjisë  
Fakulteti Filozofik  
Universiteti i Prishtinës  
"Hasan Prishtina"



CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI

Të nderuar kolegë,

Kemi kënaqësinë t'ju ftojme të merrni pjesë në Konferencën e I-rë Shkencore Ndërkombëtare të organizuar nga Departamenti i Psikologjisë Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universitetin “Hasan Prishtina” Kosovë, “Albanian University”, Tiranë, “South-West University "Neofit Rilski" Bullgari, Universita degli Studi di Bari “Aldo Moro” Itali, Universiteti shtetëror i Tetovës dhe Universiteti “N. Koperniku”, Tourun, Poloni, Fakultetin e Psikologjisë –Kolegji AAB, Prishtinë, me temë:

**“SFIDAT E KËRKIMIT SHKENCOR NË PSIKOLOGJINË E APLIKUAR DHE TË EDUKIMIT”**

**që do të mbahet më 03/06/2022 në ambientet e Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

Qëllimi kryesor i konferencës është të sigurojë një qasje akademike dhe profesionale si dhe të nxisë diskutimin mbi zhvillimet e sotme më të rëndësishme në psikologji, edukim, shëndetësi, institucionet e drejtësisë, komunitet, kërkimin shkencor etj. në lidhje me problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë drejt standarteve të Bashkimit Europian. Përfshirja në proceset integruese të Bashkimit Europian është synimi kryesor për Ballkanin Perëndimor, përfshirë dhe Shqipërinë, në rrugën për anëtarësim në BE. Sot, ne i theksojmë rëndësinë e përvojave në diskutim, modeleve të pohimit dhe propozimeve lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës përmes proceseve integruese të vendeve të Ballkanit në BE. Konferenca ka një shtrirje të gjerë në studimet në fushat e psikologjisë, edukimit, institucionet e drejtësisë, komunitetit, arsimit, etj.. duke nxitur bashkëpunimin në punime shumë disiplinore.

**Komiteti Shkencor:**

Prof.Dr. Skënder Topi Rektor UE  
Prof.As.Dr. Peçi Naqellari /zv. Rektor UE  
Prof.As.Dr. Elisabeta Osmanaj / Dekane  
Fakulteti i Shkencave të Edukimit Elbasan  
Prof.As.Dr. Lindita Durmishi / Drejtuese  
Departamenti i Psikologjisë Elbasan  
Prof.dr.Edmond Rrapti / Dekan Fakultetit  
Shkencave Sociale –Tiranë  
Prof.dr.Adem Tamo / deoartamenti i  
Psikologjisë, Fakultetit Shkencave Sociale –  
Tiranë  
Dr.Amelia Manuti / Departamenti i Edukimit,  
Psikologjisë & Komunikimit Universiteti i Barit  
“Aldo Moro”  
Prof.Dr. Dashamir Bërçulli / Dekan Fakulteti  
Filozofisë Prishtinë  
Prof.dr. Stanislava Yordanova Stoyanova /  
Neofit Rilski- Bllagoevgrad, Bullgari  
Prof.as.dr.Rusanka Mancheva / Neofit Rilski-  
Bllagoevgrad, Bullgari  
Prof. Radosław Sojak Nikola Koperniku,  
Tourun, Poloni  
Prof. Dr. Lulzim Murteza, Drejtues departamenti  
i Psikologjisë Universiteti Shtetëror i Tetovës  
Dr. Sci. Naim Telaku Dekan, Fakulteti i

Psikologjisë, Prishtinë  
Prof.As.Dr. Arjana Muça / Drejtuesedepartamenti  
i Psikologjisë Tiranë  
Prof.As.Dr. Visar Dizdari / Drejtues departamenti i  
Psikologjisë Shkodër  
Prof.dr.Fatbardha Gjini/ departamenti i PsikologjisëElbasan  
Prof.As.Dr. Ardiana Mali / departamenti i  
Psikologjisë Elbasan  
Dr. Violeta Sadiku / departamenti i PsikologjisëElbasan  
Dr.Dhurata Turku / departamenti i PsikologjisëElbasan  
Dr. Ortenca Kotherja / departamenti i PsikologjisëElbasan  
Dr. Roksana Poci / departamenti i PsikologjisëElbasan  
Dr. Ardian Tana / Zv.dekan FSHE Elbasan  
Prof.as.dr.Artemis Shehu / departamenti i PsikologjisëTiranë  
Dr. Valbona Habili / departamenti i PsikologjisëTiranë  
Dr. Elisabeta Kafia / departamenti i Psikologjisë  
/Albanian University  
Dr. Silva Ibrahim Albanian University  
Dr. Jonida Mustafaraj/ Drejtuese Departamenti i shkencave  
paraklinike dhe klinike FSHMT- Elbasan Dr. Aurela Basha /  
zv.dekane Fakulteti i Shkencave Humane Elbasan  
Dr.Manolita Hida / departamenti i Psikologjisë

### **Komiteti Organizator:**

Msc. Elona Mustafaraj  
Msc. Dorina Hasanllari  
Msc. Rudina Collaku  
Msc. Ardiola Bodinaku  
Msc. Hajdina Dyli

Msc. Rudina Xhugli  
Msc. Irena Gorrica  
Doc. Ervin Ibrahim  
Msc. Borjana Dine  
Msc. Sonila Bello

Qasja studimore e konferencës duhet t'i referohet tematikës **“Sfidat e Kërkimit Shkencor në Psikologjinë e Aplikuar dhe të Edukimit”** me fokus në nën-temat vijuese:

#### ***Në Psikologjinë e Edukimit:***

- Edukimi prindëror në mirëqënien psikoemocionale të fëmijëve;
- Rëndësia e psikologut shkollor në identifikimin e traumave;
- Faktorët mjedisor dhe ndikimi i tyre në procesin e mësimdhënies;
- Teknologjia dhe efektet e saj psiko-sociale;
- Inteligjenca dhe Kreativiteti;
- Motivacioni në klasë;
- Trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Bullizmi: Strategjitë e menaxhimit dhe trajtimit.
- Roli i mësuesit asistent në shkollë;

#### ***Në Psikologjinë Klinike:***

- Trajtimi psikologjik në rastet e Luftës dhe Fatkeqësive Humanitare: Strategjitë klinike në ndihmën e tejkalimit të ndikimeve të Luftës;
- Asistenca klinike Infermieristike për parandalimin dhe rehabilitimin Psikologjik;
- Emocionet dhe proceset e bashkëlidhura psikologjike;
- Vlerësimi dhe Psikodiagnostika: Sfidat e procesit psikodiagnostik në mjedisin Shqiptar;
- Psikoterapia dhe Këshillimi Psikologjik: Rasti i Shqipërisë dhe vendeve fqinjë;
- Sjelljet e Varësisë (Adiksioni): Sindromi Ludopatik dhe situata e Sjelljeve të Varësisë të Rinjtë Shqiptarë;
- Çrregullimet e të Ngrënit: Bulimia dhe Anoreksia Nervore;
- Çrregullimet e Personalitetit: Psikogjeneza dhe Evoluimi i tyre.
- Prototipi Diagnostik Psikodinamik: Parandalimi dhe Profiliksia në Shëndetin Mendor.
- Cilësia e Jetës dhe ndikimi i saj në Shëndetin Mendor: Perspektivat e reja vlerësuese të Ballkanit;
- Çrregullimet e Spektrumit të Autizmit (ASD): rëndësia e figurës profesionale në parandalim dhe trajtim. Formimi i specialistëve të ASD.
- Shkathtësitë profesionale në marrëdhëniet terapeutike;
- Këshillimi online dhe efektet e tij;
- Psikopatologjia dhe ndikimet në jetën e përditshme;

#### ***Në Psikologjinë Sociale:***

- Dimensionet kulturore të mirëqënies psikologjike;
- Punësimi dhe mirëqenia psikologjike e të rinjve;
- Psikologjia e Organizatës dhe e Punës;
- Psikologjia Politike dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare: Globalizimi;
- Ankthi social dhe Vetë-vlerësimi;

- Migracioni dhe Politikat Sociale;
- Kohezioni social dhe zhvillimi i identitetit;
- Stigmatizimi dhe izolimi social;
- Impakti Psikologjik dhe Social i Rrjeteve Sociale.

#### ***Në Psikologjinë Juridike dhe Ligjore:***

- Roli i figurës së specializuar të Psikologut Juridik në organet e reja të Drejtësisë!
- Dhuna dhe Trauma: Vendet e Ballkanit Perëndimor në fokusin e mirëqenies psiko-juridike;
- Mas-media dhe agresioni;
- Dhuna brenda familjes dhe me bazë gjinore (GBV);
- Kriminaliteti te të miturit;
- Legalizimi medicinal i Kanabis Sativës?;
- Sjellja agresive në fëmijëri;
- Kiberkriminaliteti;
- Mobbing në vendin e punës;
- Psikologjia Forense;
- Vlerësimi i Rrezikshmërisë për sjellje të Dhunshme (VRA);
- Agjensitë Ligjzbatuese dhe Stresi.

#### ***Në Psikologjinë Konjitive dhe Eksperimentale:***

- Sfidat e qendrave Kërkimore dhe Laboratorike në sistemin tonë universitar;
- Aftësitë e mësimnxënies dhe Edukimi i vazhduar me fokus Kërkimin;
- Neuroshkenca Konjitive;
- Inteligjenca Artificiale dhe Simulacioni Kompjuterik Konjitiv;
- Faktorët socialë dhe kulturorë në zhvillimin e qasjeve konjitive;
- Metodot Eksperimentale;
- Biopsikologjia;
- Psikogjenetika e Sjelljes.

#### **Paraqitja e punimit:**

Konferenca do të zhvillohet në seancë plenare dhe në panele të veçanta. Çdo folës (përveç folësve kryesorë) ka në dispozicion 10 minuta për të paraqitur punimin, çështjet dhe përfundimet e tyre. Çdo sesion do të ketë një moderator, që do të diskutojë mbi punimin dhe drejton punimet. Pjesëmarrësit (autorët) duhet t'i paraqesin punimet e tyre gjatë sesioneve të paneleve.

#### **Procedurat e dërgesës së punimeve në konferencës:**

Abstraktet e dorëzuara duhet të jenë relevante me objektivat e përgjithshme të tematikës së konferencës dhe me të paktën një nga nën-temat e saj. Abstraktet duhet të përshkruhen në të paktën 500-700 fjalë, të shkruara në gjuhët Shqipe, Angleze ose Italiane dhe duhet të dorëzohen në kohën e përcaktuar. Të gjitha kontributet shkencore duhet të jenë origjinale (d.m.th. të mos jenë publikuar diku tjetër), të ndjekin politikën e shkrimit akademik me strukturën dhe metodologjinë shkencore. Punimet **do të vlerësohen nga të paktën dy recensues anonimë** me ekspertizë shkencore, të cilët do të vendosin nëse abstraktet e

propozuara do të pranohen për prezantimin dhe publikimin e plotë në proceeding. Të gjitha punimet e pranuar dhe të paraqitura do të përfshihen në Librin e Punimeve të konferencës.

*Abstraktet dorëzohen elektronikisht në dy variante shqip dhe anglisht ose italisht.*

**Data të rëndësishme:**

<i>Pranimi i Abstraktit</i>	<b>23.04.2022</b>
<i>Dërgimi i punimit të plotë</i>	<b>29.04.2022</b>
<i>Njoftimi i pranimit të punimit të plot</i>	<b>27.05.2022</b>
<i>Data e konferencës</i>	<b>03.06.2022</b>

**INFORMACIONE PLOTËSUESE**

**Vendi dhe koha: Fakulteti i Shkencave të Edukimit, 03.06.2022**

**Gjuha e konferencës: shqip, anglisht, italisht.**

**Për tarifën dhe mënyrën e pagesës**

Psikologët që do të pajisen me *kredite*: 5000 Lekë

Referues (jo psikologë): Referuesi i parë 3000 Lekë, Referuesi i dytë 1000 Lekë etj,

Fatura e arkëtimit gjendet në: <https://uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-te-edukimit/njoftime>

*Konfirmimi për pranimin e punimit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të autorit korrespondues.*

**Format e prezantimit të punimeve:**

- Prezantim Verbal
- Prezantim me Power point

Për dërgimin e materialeve si dhe çdo pyetje lidhur me konferencën, ju lutem të mos hezitoni të kontaktoni:

Adresa e e-mail: [konferenca.psikologjia@uniel.edu.al](mailto:konferenca.psikologjia@uniel.edu.al)

Do të ishim mirënjohës nëse ju e ndani këtë Thirrje për Pjesëmarrje në Konferencë edhe me kolegët dhe bashkëpunëtorët tuaj.

Ju falenderojmë për interesimin tuaj,  
Komiteti Organizues i Konferencës

## UDHËZIME PËR ABSTRAKTIN E PUNIMIT

Abstraktet e dorëzuara duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Abstrakti i punimeve të paraqitura duhet të dërgohet në gjuhën shqipe dhe anglisht.
- Abstrakti duhet të tregojë qartësisht qëllimin e kërkimit dhe lidhjen e tij me temën e Konferencës, dhe me seksionin përkatës, qasjen e përdorur, rezultatet kryesore të kërkimit dhe rëndësinë e tyre.
- Përmbajtja e abstraktit duhet të jetë deri në 500-700 fjalë (12pt Times New Roman, Bold, Justify, Hapësira mes rreshtave 1.5) dhe të paraqesë qëllimin dhe metodologjinë e kërkimit, rezultatet dhe përfundimet.
- Titulli i punimit (14 pt Times New Roman, Bold, i qendëruar, me shkronja të mëdha.
- Emrat e autorëve: Emri i plotë i autorit (autorëve), statusi, institucioni dhe adresa e-mail për secilin prej autorëve. (Me shkronja të mëdha, 12 pt Times New Roman, në qendër. Institucioni ose Departamenti dhe Universiteti (12 pt Times New Roman, në qendër. E-mail(për komunikim) 12pt Times New Roman, në qendër, i rrafshuar në të dy skajet).
- Fjalët kyçe: 5-7 fjalë të renditura alfabetikisht (12pt Times New Roman, Normal). Maksimumi 5 fjalë kyç duhen përfshirë menjëherë pas abstraktit. Fjalët kyç shërbejnë për të tërhequr vëmendjen e lexuesit, si dhe për përzgjedhjen e artikujve në baza elektronike informacioni. Fjalët kyç është mirë që të përmbledhin temën, nëntemën, llojin e studimit, popullatën, vendin e zbatimit të studimit.
- Format: Abstrakti duhet të dorëzohet në format Microsoft Word, shkrimi në formatin A4, lloji i gërmës:12 pt., font - Times New Roman.

## UDHËZIMET PËR SHKRIMIN E PUNIMIT

Punimet e plota duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Punimi duhet të jetë origjinal dhe i pa publikuar më parë .
- Punimi duhet të shkruhet në Microsoft® Office Word, i formatuar në **letër A4**, me një hapësirë 4.5cm nga të gjitha anët, fontin duhet të jetë Times New Roman, single line (vijëzimi justified), me font 12, hapësira midis rreshtave 1.15. Artikulli i formatuar sipas këtyre udhëzimeve, bashkë me formulat, tabelat, figurat dhe fotografitë duhet të jetë jo më pak se 6 faqe dhe jo më shumë se 10 faqe.
- Autori duhet të shkruajë si rregull në vetën e tretë duke përdorur shprehje si: quhet, konsiderohet, arrihet në përfundim se, vërtetohet se etj.
- Në një punim janë të detyrueshëm elementët e mëposhtëm:
  - o Titulli
  - o Autori(ët) në një rresht;
  - o Adresa(t) elektronike përkatëse korresponduese;
  - o Konkluzionet;
  - o Referencat.
- Rekomandohet që në strukturën e një punimi të konsiderohen edhe elementet e mëposhtëm:

- Hyrja,
- Sfondi teorik
- Formulimi i problemit dhe qëllimeve të hulumtimit
- Pyetjet dhe hipoteza
- Materiali dhe metodat,
- Rezultatet dhe diskutimet,
- Përfundimet

- Referencat: Burimet e literaturës duhet të listohen në mënyrë alfabetike në bazë të kritereve të aplikuar APA 16. Referencat duhet të vendosen në fund të punimit. Çdo burim i përmendur në shkrim duhet të pasqyrohet në bibliografi dhe anasjelltas, burimet e dhëna në bibliografi duhet t'u përgjigjen citimeve të bëra gjatë punimit.